



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.8, datë 30/05/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS “PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË
LEJES/AUTORIZIMIT”, P.F “FLUTURIM KOXHAJ”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime teknologjike (lavazh) me Nr.serie:0014, miratuar nga KBU Ishëm-Erzen me Vendim Nr.13, datë 12.07.2018, P.F “Fluturim Koxhaj”, me vendndodhje, Rruga “Xhanfize Keko”, Bashkia Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- X= 486974.8

- $Y=4578393.0$
- $Z=160$ m.m.n.d

- Prurja mesatare : $Q_{mes}=0.3$ l/s
- Sasia e ujit për përdorim : $Q=0.3$ l/s
- Qëllimi i përdorimit : Ujë teknologjik (lavazh)
- Shkarkimi i ujërave të përdorur : Sistemi i kanalizimeve.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBË ISHËM

EMILJAN JANI

